



Stadt Chur



Deutsch für die Schule

Gjermanisht për shkollën

Mësimi i gjermanishtës një vit para kopshtit parashkollor

Informata për prindër

Kur një fëmijë i moshës pesë vjeçare fillon në kopshtin parashkollor duhet të kuptoj në gjuhën gjermane. Nëse një fëmijë flet pak apo aspak gjermanisht, atëherë ai e viziton programin Përkrahje e hershme gjuhësore "Deutsch für die Schule".

Përse të mësohet gjermanishtja para kopshtit parashkollor?

Fëmijët, të cilët kur fillojnë në kopshtin parashkollor fare pak apo aspak nuk flasin gjermanisht, e nisnin rrugëtimin e tyre shkollor me premisa më të dobëta se shokët dhe shoqet e tyre gjermanfolës të klasës. Zgjat me vite, deri kur fëmijët e zotërojnë gjuhën gjermane që përdoret në rrethin e tyre. Për këtë arsye është e rëndësishme, që ata para fillimit në kopshtin parashkollor të mund të mësojnë gjermanisht.

Për këtë arsye, në ligjin shkollor të Chur-it (711, neni 39) është vendosur baza themelore, që fëmijët parashkollor me pak apo aspak njohuri të gjuhës gjermane të mund të mbështetën përmes programit "Deutsch für die Schule". Pjesëmarrja e prindërve dhe fëmijëve të tyre mund të sqarohet si e obligueshme.

Si mësojnë fëmijët e vegjël gjermanisht

Fëmijët e vegjël mësojnë, nëse ata ndihen mirë dhe të sigurt. Ata e mësojnë gjuhën nëpërmjet një ambienti tërheqës, përmes kontaktit me personin e besueshëm në situatat e përditshme dhe përmes lojës me fëmijët e tjerë. Personeli i ynë i kualifikuar te grupi i lojërave, çerdhet, kopshtet familiare ditore, dhe në kopshtet e hershme parashkollore kanë kualifikime të veqanta dhe mbështesin zhvillimet gjuhësore përmes lojërave me cak (qëllim) të caktuar. Përveq mësimin të gjermanishtës, fëmijët bëjnë edhe përvoja të rëndësishme në grupet e fëmijëve, e zhvillojnë personalitetin e tyre dhe bëhen më të pavarur. Fëmijët do të kenë mbështetje të gjithanshme.



Si vlerësohet, se a mundet fëmiu i im të flas mjaftueshëm gjermanisht?

Një vit e gjysmë para fillimit në kopshtin parashkollor, qyteti Chur u'a dergon prindërve një pyetësor. Përmes kësaj, prindërit mundën saktë të cilësojnë njohuritë e gjermanishtes të fëmiut të tyre, edhe nëse ata vet nuk flasin gjermanisht. Pyetësori është zhvilluar nga Universiteti i Basel-it, dhe ai është në dispozicion në shumë gjuhë.

Prindërit duhet ta plotësojnë pyetësorin në mënyrë vetëm të vërtetë dhe ta dërgojnë (kthejnë) prapa. Rezultati i pyetësorit do t'u komunikohet prindërve me shkrim. Nëse vie në përfundim se fëmiu ka nevojë për mbështetje, prinderët e marrin një formular për lajmërim (regjistrim) për pjesëmarrje në programin "Deutsch für die Schule". Nëse prindërit e refuzojnë regjistrimin në këtë program, ata mundën të bëjnë një deklaratë (qëndrim) me shkrim dhe ta dërgojnë te qyteti i Chur-it. Mospjesmarrja në program mund të ketë për pasojë gjobitjen, sipas ligjit për gjobat, neni 292.

Regjistrim në program – si më tutje?

Prindërit e pranojnë së bashku me formularin e regjistrimit edhe listën me emrat e grupeve të lojërave, çerdheve, kopshteve familjare ditore dhe kopshteve parashkollore të hershme. Prindërit e zgjedhin një institucion nga ajo listë dhe marrin kontakt me atë, shkojnë dhe bëjnë një „provë“ dhe e rezervojnë një vend në grup. Sipas dëshirës, udhëheqja e Programit i mbështet prinderit në kërkimin e një vendi.

Sa shpesh duhet fëmiu im të marr pjesë në program?

Fëmijët janë të obliguar që një vit para fillimit në kopshtin parashkollor të mësojnë gjermanisht dy gjysmë ditë në javë apo një ditë të plotë në javë (së paku 6 orë në javë). Vijimi i rregullt i mësimin të gjermanishtes është i obligueshëm. Grupet e lojërave i përshtaten pushimeve të shkollave të qytetit të Chur-it. Çerdhët e fëmijëve e fillojnë programin vjetor zakonisht me 1 gusht dhe e përfundojnë me 30 qershor.

Sa paguajn prindërit?

Qyteti Chur merr pjesë në shpenzimet e përkujdesjes në formë të zbritjes së tarifave. Këto zbritje janë të rregulluara (përshkallzuara) sipas të ardhurave dhe pasurisë që tatimohen dhe arrijnë prej 20% deri në 80% të tarifave adekuate.

Orët apo ditët plotësuese i paguajn vet prindërit.

Si marrin pjesë prindërit në program?

Prindërit, fëmijët e të cilëve marrin pjesë në programin "Deutsch für die Schule" i vizitojn 8 takime të prindërve, të cilat janë të shpërndara në tërë programin vjetor. Përmes këtyre takimeve prinderit informohen lidhur me zhvillimin gjuhësor të fëmiut të tyre, fillimin në kopshtin parashkollor, sistemin shkollor të Zvicrës, ofertat e qytetit të Chur-it për kohën e lirë si dhe tema të tjera të rëndësishme. Edhe prindërit që janë të punësuar dhe prindërit që nuk kanë njohuri të gjermanishtës mund të marrin pjesë në program. Oferta për edukim të prindërve është pa pagesë.

Kontaktimi

Programm "Deutsch für die Schule"
Klostergasse 11, Postfach 810, 7001 Chur

☎ 081 254 46 24

✉ dfs@chur.ch



Informata të tjera: